

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtarja e çështjes F. D. me zyrtaren ligjore Edona Grajçevci, në çështjen penale kundër të akuzuarit R. M., për shkak të veprës penale Kanosje nga neni 185 par. 1 të KPRK-së, i akuzuar me aktakuzën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, PP.II.nr.172/2016 të datës 18.03.2016, në shqyrtimin fillestar, publik, të mbajtur me datë 23.01.2018, në prezencën e përfaqësuesit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, prokurorit të shtetit Enver Krasniqi dhe të akuzuarit, në të njëjtën ditë mori dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

R. M., i biri i R. dhe nënës H., e vajzërisë K., i lindur me *data e lindjes...*, në fsh.P., KK.B., tani me vendbanim në rrugën “...” nr....-D., Gj. me nr. personal *numri personal...*, me nr. të tel. *Numri i telefonit...*, ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, baba i 4 fëmijëve, i punësuar në agjensionin BERN, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar shtetas i Republikës së Kosovës dhe shtetas i R. Serbisë,

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

Me datë 05.01.2016, rreth orës 15 – 16 h, në rrugën “...”, në P., i pandehuri, me dashje, seriozisht e ka kanosur të dëmtuarin Sh. M., me fjalët se do t’i shkaktoj ndonjë të keqe, në atë mënyrë që pasi të njëjtit ia ka caktuar datën 12.01.2016, që të kthehet tek gruaja e tij (vajza e të pandehurit) me të cilën ka bashkëjetuar për dy vite rresht, sepse, nëse nuk e ndërmerret këtë veprim “familja e të pandehurit do të hakmerret sipas kanunit”, me ç’rast tek i dëmtuari ka shkaktuar ndjenjën e frikës, ankthit dhe pasigurisë,

- **Me çka ka kryer veprën penale Kanosje nga neni 185 par. 1 të KPRK-së.**

Prandaj gjykata në bazë të nenit 4, 7, 17, 21, 41, 49, 85, 74 të KPRK-së dhe neneve 365, 366 të KPPRK-së, i shqipton:

VËREJTJE GJYQËSORE

Me këtë vërejtje i bëhet me dije të akuzuarit **R. M.**, se e ka kryer veprën penale dhe nëse përsëritet vepër tjetër penale gjykata do t’i shqiptoi dënim më të rëndë penal.

Obligohet i akuzuari që të paguaj shpenzimet procedurale në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 25.00€, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Pala e dëmtuar, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest të rregullt juridiko – civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, pranë kësaj gjykate ka parashtruar aktakuzën PP.II.nr.172/2016 të datës 18.03.2016, me të cilën ka akuzuar A. D., për shkak të veprës penale Kanosje nga neni 185 par. 1 të KPRK-së.

Me datë 23.01.2018, gjykata ka caktuar shqyrtimin fillestar lidhur me këtë çështje juridike në të cilën prezantuan përfaqësuesi i Prokurorisë Themelore në Prishtinë, prokurori i shtetit Enver Krasniqi dhe i akuzuari R. M.. Pas leximit të akuzës nga prokurori i shtetit, i akuzuari e pranoi fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet.

Prokurori i shtetit u pajtua me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit.

Meqenëse pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit ishte i plotë dhe bindës dhe se pohimi i tij për veprën penale të kryer përputhej në tersi me provat tjera që gjenden në shkresat e lëndës, të gjitha këto në mënyrë të plotë dhe të argumentuar e vërtetojnë gjendjen faktike, gjykata e aprovoi pranimin e fajësisë së tij.

Meqenëse i akuzuari e pranoi fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohej, gjykata nuk bëri administrimin e provave, por vazhdoi me matjen e dënimit.

Duke pasur parasysh këtë gjendje të vërtetuar faktike, me rastin e matjes së dënimit, llojit dhe lartësisë së tyre gjykata mori parasysh të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese në vështrim të nenit 41 të KPRK-së e të cilat janë me ndikim me rastin e individualizmit të dënimit, ashtu që rrethana rënduese për të pandehurin nuk gjeti, kurse si rrethanë lehtësues për të pandehurin mori faktin se asnjëherë më parë nuk ka qenë i dënuar, se e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën e ngarkonte akuza, si dhe duke pasur parasysh deklaratën e Prokurorit të Shtetit, i cili deklaroi: pasi që i pandehuri e pranoi fajësinë me vullnetin e tij, pa presion dhe në pajtim me dispozitat e KPP, i ka propozuar gjykatës që pranimin e fajësisë ta aprovojë, dhe ta marrë si rrethanë lehtësuese, me rastin e matjes së dënimit. Gjukata pas vlerësimit të gjithanshëm të të gjitha rrethanave dhe deklaramit të palëve, ka ardhë në përfundim se edhe me këtë masë do të arrihet qëllimin i dënimit, andaj gjykata vlerësoi se edhe pa shqiptimin e ndonjë dënimi por vetëm me vërejtjen e shqiptuar gjyqësore mund të arrihet qëllimi i dënimit.

Vendimi mbi obligimin e të akuzuarit që t'i paguaj paushallin gjyqësor u muar konform nenit 456 të KPPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushalli gjyqësor është marrë në bazë të nenit 456 të KPPRK-së.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
P.nr.1424/16, me datë 23.01.2018

Procesmbajtësja
Edona Grajçevci

Gjyqtarja
Fatime Dërmaku

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar Ankesa në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë e nëpërmes kësaj gjykate.